



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 22900/19 Prot.

Tiranë, më 4.4.2019

URDHËR

Nr. 122, Datë 4.4.2019

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËRZGJEDHËSE TË KANDIDATIT PËR ANËTAR
BORDI TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINACIARE QË DO TË MBAJË
FUNKSIONIN E NËNDREJTORIT EKZEKUTIV**

Në mbështetje të neneve 4, 5, 7 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" të ndryshuar, si dhe në zbatim të paragrafit të katërt të nenit 6 të këtij ligji;

Me qëllim, përzgjedhjen e kandidatit për anëtar bordi të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv, i cili sipas procedurës dhe përcaktimeve ligjore do t'i propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për emërim,

URDHËROJ:

- 1) Fillimin e procedurës përgjedhëse të kandidatit për anëtar bordi të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv, i cili sipas procedurës dhe përcaktimeve ligjore, do t'i propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për emërim.
- 2) Në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 5 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" të ndryshuar, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:
 - a) Të jetë shtetas shqiptar;
 - b) Të ketë kryer arsimin e lartë ekonomik, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve.
 - c) Të ketë përvojë pune 7-vjeçare, nga e cila të paktën 5 vjet në njerën nga këto fusha ose disa prej tyre të marra sëbashku:
 - Financë-kontabilitet;
 - Administrim i shoqërive tregtare;
 - Këshillim ligjor i shoqërive tregtare;
 - Hartim legjislacioni;
 - Shkencë e aktuarëve;

